



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:165315

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05670835

C.nr.758/2021

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË**, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me bashkëpunorën profesionale Mirvedete Bekteshi, në çështjen juridike civile sipas padisë së paditësit F. H, mësimdhënës në SHFMU“Bajram Curri” në N, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. B. B nga S, ndaj të paditurës K së S, D së A, përfaqësuar nga A. B, me akt emërim, për shkak të kompensimit në emër të kualifikimit – licencimit, pagës jubilarë dhe shujtave ditore, vlera e kontestit e pa përcaktuar, me dt.10.05.2024, bie këtë,

## **A K T G J Y K I M** **Pa shqyrtim kryesor**

**I. APROVOHET** e bazuar kërkesëpadia e paditësit F. H, mësimdhënës në SHFMU“Bajram Curri” në N. K. S.

**II. DETYROHET** e paditura K e S – D. K e A, që paditësit F. H :

- në emër të kompensimit të kualifikimit - licencimit prej 27% të pagës bazë  $421 \times 27\% = 113.67 - 58.32$  diferenca prej 55.32 euro për 36 muaj nga data 22.07.2018 – 22.07.2021, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej **1.992,60 euro (Njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy euro e gjashtëdhjetë cent)**;

-në emër të kompensimit të pagës jubilarë për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë prej 50 % të një page bazë 421 E, ti paguaj shumën prej **210.10** euro dhe

-në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 01.09.2020 deri me 01.04.2022 për 240 ditë pune, x 2 euro = **480 €**, në shumën e përgjithshme prej **2.682.70**, (dymijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy

**euro e shtatëdhjetë cent)** si dhe kamatëvonesën në vlerën prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë 27.07.2021 e deri në pagesën definitive.

**III. OBLIGOHET** e paditura që paditësve t’ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës dhe atë; për përpilimin e padisë 104 euro, për precizimin e padisë 104 Euro dhe 21 për taksë gjyqësore, në total shumën 229 euro sipas TOAK-së, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësi F. H, mësimdhënës në SHFMU“Bajram Curri” në N, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. B. B nga S, ka parashtruar padi me datën 27.07.2021 kundër të paditurës K e S – D. K e A, për pagesën e kompensimit kualifikimit – licencimit, pagës jubilarë dhe shujtës, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, Me parashtresat e datës 12 dhe 13.02.2024 i autorizuari i paditësit ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe llogaritjen për pagesën e diferencës për licencimin-gradimin, pagën jubilarë, shujtave ditore dhe shpenzimet sipas tarifës së OAK-së.

E paditura Aktvendimin e Gjykatës C.nr. 758/2021 të dt. 11.02.2022 e ka pranuar me datë 21.03.2022, mirpo nuk ka ushtruar përgjegje në padi. Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkangjitura padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se: Kërkesëpadia e paditësve është **e bazuar**.

Në nenin 7 par. 1 i Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: “Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.”

Nga analizimi i provave - kontratës së punës të lidhur mes ndërgjyqësve, ka konstatuar se licencimi është paguar vetëm pjesërisht nga ana e të paditurës, ndërsa nuk ka paguar edhe pjesën tjetër të obligimit në bazë mujore, poashtu në bazë të provave konstatohet se paditësit nuk i është paguar paga jubilarë për prej 50 % të pagës bazë dhe shpenzimet e shujtave ditore, andaj konsiderojmë se e paditurua ndaj të njejtit ka për obligim t’ia paguaj kompensimin e kualifikimit – licencimit, kompenzimin e shujtave ditore dhe pagën jubilarë për 10 vite pune.

I autorizuari i paditësit, me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin e kualifikimit – licencimit, kompenzimit jubilar dhe kompenzimin e shujtave ditore, i ka bashkëngjitur padisë Listën e pagës, kontratën e punës nr.14/V, Licencën e mesimdhënësit nr. 100010508, Diplomën me nr. 780, vërtetimet nga marëdhënia e punës nr.107/V, nr. 68/V dhe autorizimin.

Bazuar në provat e lartcekur, shihet se kërkesa e paditëseve gjen mbështetje të plotë në nenin 7 par.1.3 të Kontratës Kolektive e 18.04.2017, ndërmjet SBASHKU-ut dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, siç parashihet se ‘*Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim, karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe të: Mësimdhënës me shkollë normale 10% e pagës bazë, Mësimdhënës me shkollë të lartë pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë, Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri vjeç dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë*, kërkesa e paditësit për pagesën e pagës jubilarë për 10 vite punë, gjen mbështetje të plotë në nenin 35 paragrafin 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2015 dhe 2017. në të cilën thuhet: “Punëtorët (anëtarë të SBASHKU-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, **në vlerë për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50 % të një page bazë**, shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti” dhe

kërkesa për shujtat *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, **për një ditë punë, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare të institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim.***

Gjykata ka vërtetuar se e paditura është e obliguar ndaj paditëseve konform nenit 7 dhe 35 par. 5, par. 7. Dhe par 8.nën pr. 83. të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, që t’ia paguaj kompensimin licencimin në vlerën 27%, të pagës bazë, kompenzimin jurbilar në vlerë prej 50% të pagës bazë dhe shujtat ditore dy euro në ditë, deri me datën 01.04.2022, dhe këtë obligim e paditura e ka përmbushur vetëm pjesërisht, andaj vendosi që paditësit t’i kompensohet shuma e papaguar e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi që t’ia falte besimin provave që ka prezantuar paditësja, konkretisht Listën e pagës, kontratën e punës nr.14/V, Licencën e mesimdhënësit nr. 100010508, Diplomën me nr. 780, vërtetimet nga marrëdhënia e punës nr.107/V, nr. 68/V, me të cilat u vërtetua se paditësi është i punësuar në SHFMU“Bajram Curri” në N. K. S, dhe në bazë të listës së pagës u vërtetua se i njëjti pagën bazë e ka 421 euro, për licencim nga e paditura është kompensuar vetëm pjesërisht siq është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi aprovimin e kërkesëpadisë, është mbështetur në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/33 të datës 29.08.2008 nenit 7 dhe neni 35 par. 5, parag 7 dhe paragrafi 8 nën par. 8.3. të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, e cila është akt më i lartë se kontrata e punës në mes paditësit dhe të paditurës, kjo bazuar sipas nenit 4 të Ligjit të Punës, theksohet se hierarkia tek marrëdhënia e punës së pari vlen Ligji i Punës, pastaj Kontrata Kolektive e më pas kontrata në mes të punësuarit dhe punëdhënësit.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së

Gjykata Aktgjykimin e muarr në kuptim të nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**

**C.nr.758/2021, datë 10.05.2024**

**Gj y q t a r i**  
**Robert Tunaj**

---

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej **7 ditëve** nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.